



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI KOMBETARE I UJIT  
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

**LEJE**

**PER PERDORIM REZERVE UJORE**

**Nr. 13 , date 05.09.2012**

- A - Emri dhe adresa e marresit te “Lejes per Perdorim te Rezerves Ujore”.**  
Shoqeria “ Puka Group ”,sh.p.k. me administrator z. Blerim Qarri.  
Qyteti Puke, Bjeshka Terbunit.
- B- Objekti i lejes dhe specifikimet e tij.**  
Burimi ujqor, Burimi i Peshve.  
Baseni Ujembledhes Drin – Bune, Rrethi Puke.  
Burimi ujqor eshte ne pronesi shtetore dhe ka keto specifikime:  
Koordinatat: X- 4655037; Y- 4409450; Z- + 810 m.  
Prurja mesatare 4 - 6 L / sek.
- C - Sasia e ujit qe jepet per perdorim 3 L / sek.**  
Vendshkarkimi i ujrave te perdorura ne Perroin e Gomsiqes.
- D- Aktiviteti per te cilin do te perdoret kjo rezerve ujore eshte:**  
Per ambalazhim uji.
- E- Kjo leje eshte e vlefshme deri me date:** 04.09.2017. Marresi i kesaj leje eshte i detyruar te plotesoje te gjitha kushtet qe i bashkengjiten kesaj leje.

**K R Y E T A R E,**

**KESHILLIT TE BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**



**Voltana ADEMI**

Kjo leje leshohet bazuar ne ligjin nr. 8093,dt.21.03.1996, ”Per rezervat ujore”,neni 14. Qellimi i perdorimit te rezerves ujore specifikohet ne paragrafin D, te kesaj leje.

### KJO LEJE PERDORIMI JEPET ME KETO KUSHTE:

1. Te respektohet qellimi per te cilin kerkohet ky autorizim.
2. Te respektohen kushtet higjeno-sanitare dhe te mbrojtjes se mjedisit perreth.
3. Perdoruesi i ujit eshte i detyruar te vendose mates uji me shpenzimet e veta, sipas rregullave qe vendosin autoritetet e ujit, qe japin lejen.
4. Kur uji perdoret si produkt si ushqimor, procedurat e prodhimit duhet te jene konform rregullave te Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit.
5. Burimi ujqor te shfrytezohet nga zoteruasi i lejes. Leja ndalohet t'i transferohet nje subjekti tjetet.
6. Te mos kryhen veprime qe sjellindrejtperdrejt ose si pasoje, demtimin e burimit ujqor.
7. Te mos pengohet kontrolli i shfrytezimit te ujit qe kryhet nga Agjencite e Ujit te Keshillave te Baseneve Ujembledhes, nga Sekretariati Teknik i KJU, ose persona te autorizuar prej tyre.
8. Per shkeljen e kushteve ligjore te kesaj leje, do te merren masa ne perputhje me Kreun XVI te ligjit nr. 8093, dt. 21.03.1996 "Per rezervat ujore".
9. Zoteruesi i lejes paguan per shpenzimet administrative dhe tarifen per ujin e shfrytezuat, bazuar ne vendimet perkatese te Keshilit te Ministrave.

### NDRYSHIMI OSE ANULLIMI I LEJES:

Kjo leje mund te ndryshohet pjeserisht ose te anulohet plotesisht, [ara mbarimit te afatit te percaktuar, kur:

1. Perfituesi i lejes shkel njerin nga kushtet e parashikuara me siper.
2. Organi kompetent per nxjerrjen e lejes ben azhornimet perkatese lidhur me burimin konform ndryshimit te planeve te rezervave ujore, ndryshim i cili prek dhe burimin ujqor, objekt te kesaj leje.
3. Kushtet e dhenies se lejes kane ndryshuar.
4. Burimi ujqor eshte drejt shterimit.
5. Kur aktiviteti qe ushtrohet, bazuar ne lejen e dhene, eshte shkak i ndotjes se burimit ose mjedisit.

Ne qofte se per shkak te forcave madhore ndodhin ndryshime ne prurjen, cilesine, kufijte e burimit, etj dhe keto ndryshime sjellin pamundesine e perdorimit te tij nga zoteruesi i lejes, ky i fundit ka te drejte t'i drejtohet organit kompetent qe i ka dhene lejen, per ta anuluar ate.